

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQËRISË " AC PROPERTIES" SH.P.K.**

Sot, me datë 06.11.2025

*Z. Admir Çelo, shtetas Shqiptar, lindur më 15/01/1975 në Tirane, Shqiperi, mbajtëse i Kartes se ID me nr.me 039203916 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.*

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " AC PROPERTIES" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### **NENI 1 EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është AC PROPERTIES” Sh.p.k.

#### **NENI 2 SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Eduard Mano, Pll 5, AP 10, Zona kadastrale 3292 Selite Tirane. Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

#### **NENI 3 KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

#### **NENI 4 OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

*- Investitor ne ndertim; blerje, shitje, dhënie me qira dhe menaxhim pronash të paluajtshme; ndërmjetësim në tregun e pasurive të paluajtshme dhe çdo veprimtari tjetër të ligjshme që lidhet me objektin kryesor të shoqërisë.*

#### **NENI 5**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 1,000,000 Lek (nje milion leke) dhe përbëhet nga 1 kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- Z. Admir Çelo zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1,000,000 Lek dhe 1,000,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z Admir Çelo** i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Admir Çelo**, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. H50115052D, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKËT THEMELUES**

**Admir Çelo**

